



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E EKONOMISË KULTURËS DHE INOVACIONIT  
AGJENCIA KOMBËTARE E PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE  
SHKOLLA E MESME TEKNOLOGJIKE "HYSEN ÇELA" DURRËS

Nr. 606 Prot.

Durrës, më 03.03.2024

**Lënda:** Njoftim për lëvizje paralele.

**DREJTORISË JURIDIKE DHE BURIMEVE NJERËZORE  
AGJENCISË KOMBËTARE TË PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE**

**Rruga "Bulevardi Bajram Curri", Tiranë**

Në zbatim të ligjit nr.15/2019, "Për nxitjen e punësimit", të ligjit nr.15/2017, "Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë", të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.554, datë 31.7.2019, "Për krijimin, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive", të Udhëzimit nr. 14, datë 27.05.2021, "Për mënyrën e organizimit dhe veprimtarisë së institucioneve të arsimit dhe formimit profesional, si dhe aspektet e menaxhimit të burimeve njerëzore, përbërjes së njësisë së zhvillimit të ofruesve të arsimit dhe formimit profesional dhe zhvillimit të vazhduar profesional të personelit". Shkolla e mesme teknologjike "Hysen Çela" ju njofton krijimin e vendit të lire vend vakant per pozicionin

- Pozicioni: Mësues me orë i teorisë profesionale, drejtimi Hoteleri-Turizëm ( Baza Sipërmarrje)

**1. Kriteret e përgjithshme dhe kriteret e posaçme**

Aplikanti duhet të plotësojë kriteret e përgjithshme si vijon:

**1. Kriteret e përgjithshme:**

a) të ketë zotësi të plotë për të vepruar; b) të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën; c) të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e veprave penale; d) të mos ketë ndaj tij masa disiplinore që nuk janë shuar; e) të demonstrojë vlera të larta të etikës, sjelljes dhe komunikimit; f) të demonstrojë aftësi të punës në grup dhe të motivimit.

Aplikanti duhet të plotësojë kriteret e posaçme si vijon:

## 2. Kriteria të posacme për personelin mësimdhënës të teorisë profesionale në ofruesin e AFP-së që ofrojnë arsim profesional .

a) Të ketë të paktën diplomë të nivelit mesatar ose të barasvlefshme, në të njëjten fushë me njerin nga kualifikimet profesionale të ofruesit të AFP-së ,për të cilin /cilat po aplikon .b) të ketë të paktën 1 (një) vjet përvojë pune në fushën, në të cilën ka kryer studimet; c) të njohë dhe të përdorë teknologjinë e informacionit;

## 3. Dokumentet e aplikimit

Dosja e aplikimit, e cila përmban dokumentacionin e kërkuar, sipas njoftimit të vendit të lirë, duhet të përfshijë: a - letërmotivimin për pozicionin; b- jetëshkrimin (CV-në); c- kartën e identitetit; d- diplomën; e- librezën e punës; f- çdo dokumentacion tjetër që vërteton kualifikimet, trajnimet apo të tjera të përmendura në CV; g- certifikatën ose dëshminë për nivelin e njohurive në teknologjinë e informacionit; h- vërtetimin e gjendjes shëndetësore; i- vërtetimin e gjendjes gjyqësore; j- vërtetimin nga punëdhënësi i fundit, që ndaj tij nuk ka marrë masa disiplinore në fuqi, k - të paktën një rekomandim ose vlerësim pune nga punëdhënësi të mëparshëm.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose të noterizuara; Dokumentet në gjuhë të huaj duhet të jenë të përkthyer dhe të noterizuara.

Dokumentet e aplikimit dorëzohen në protokollin e Shkolles së Mesme Teknologjike “Hysen Çela”. brenda datës ...13.09.2024

Shënim : Për levizje paralele nuk u paraqit asnjë dosje.

**DREJTORE**

**Dr. Blerina DERVISHI**

